



Federata Aeronautike e Kosovës

RREGULLORJA PËR RREGJISTRIMIN E REKORDERVE KOMBËTARE

Kryesia e Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen e vet të mbajtur më 04.03.2015, aprovoi:

RREGULLOREN 04/2015

RREGJISTRIMI I REKORDEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret për rregjistrimin e rekordeve kombëtare të Republikës së Kosovës.

Neni 2.

Rekordet kombëtare regjistrohen vetëm nga pilotët e licensuar nga autoriteti rregullativ i aviacionit civil të Republikës së Kosovës (CAA).

Neni 3.

Me rekord kombëtarë nënkuptohet një rekord i arritur/regjistruar nga një pilot i Republikës së Kosovës në një nga kategoritë e përcaktuara për regjistrim të rekordeve, pa marrë parasyshë lokacionin se ku është arritur ky rekord. Rekordi i prezantuar tek komisioni për paragllajdzëm në kuadër të FAK, duhet të jetë në formatin digjital (*.igc) dhe i njëjti të jetë i vendosur në portalin për regjistrim të fluturimeve të lira Leonardo (<http://www.paraglidingforum.com/leonardo>) .



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 4.

Kategoritë për regjistrim të rekordeve në fluturim të lirë janë paraqitur në tabelën vijuese:

- 4.1. Rekordi në distancë lineare
- 4.2. Rekordi në distance cross country
- 4.3. Rekordi i kohëzgjatjes së fluturimit
- 4.4. Rekordi i lartësisë maksimale të arritur gjatë fluturimit
- 4.5. Rekordi i lartësisë maksimale të fituar gjatë fluturimit

Neni 5.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj, pra ndryshimet propozohen nga komisioni për paragllajdzëm në kuadër të FAK si dhe dëgohen për votim në kryesinë e FAK.

Neni 6.

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 04.03.2015

Kryetari i FAK
Fadil Gërguri

Kryetari i komisionit për paragllajdzëm
Ardall Celina